

KËSHILLI KOMBËTAR I PAKICËS KOMBËTARE SHQIPTARE

RREGULLORJA E PUNËS SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË PAKICËS KOMBËTARE SHQIPËTARE

NË BUJANOC, JANAR 2011.

Në mbështetje të nenit 15. alineja 1.pika 1. të statutit të këshillit kombëtarë të pakicës kombëtare shqipëtare Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare,në mbledhjen e mbajtur më 13.01.2011 vit. miratoi këtë :

RREGULLORE TË PUNËS SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË PAKICËS KOMBËTARË SHQIPËTARE

I . DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë rregullore në harmonizim të Ligjit për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare , Statutit dhe akteve tjera normative , rregullohet organizimi dhe mënyra e punës së këshillit kombëtarë të pakicës kombëtare shqipëtare.

Neni 2.

Në mbledhje të Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare shqipëtare, në përdorim zyrtar të gjuhës,është gjuha shqipe dhe shkrimi i saj, si dhe gjuha sërbe në raste nevoje me përkthim stimultan, dhe shkrimi I saj për hirë të shpalljes së akteve juridike të cilat miratohen në mbledhje, të cilat shpallen në gazetën zyrtare të Republikës së Sërbisë.

**II. KONSTITUIMI I MBËLEDHJES SË PARË TË KËSHILLIT KOMBËTARË TË PAKICËS
KOMBËTARE SHQIPËTARE**

Neni 3.

Mbledhja konstituive - pas përfundimit të zgjedhjeve, mbledhjen e parë konstituive e konvokon Ministri për të drejtat e njeriut dhe të pakicave, në mbështetje të Ligjit për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare.

Mbledhjen e parë gjithashtu e udhëheqin përfaqësuesit e ministrisë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave.

Kjo ministri po ashtu propozon edhe rendin e ditës.

Sipas rregullit, mbledhja e parë duhet ta ketë këtë përmbajtje.

- 1. Raporti i KQZ mbi rezultatin e zgjedhjeve.**
- 2. Verifikimi i mandateve të anëtarëve të KKSH.**
- 3. Dhënja e deklaratës solemne e anëtarëve.**
- 4 Zgjedhja e presidences së punës ose komisionin zgjedhor.**
- 5. Zgjedhja e kryetarit KKSH.**
- 6. Miratimi i rregullores së punës.**

Neni 4.

Për mbledhjen e parë konstituive të KKSH, çdo anëtar ka të drejtë të propozoj, ndëroj rendin e ditës, dhe të paraqes arësyetimin, më së shumti në kohë zgjatje **2**. minuta.

Për ndryshimin e rendit të ditës nuk hapet diskutim. kryesuesi pastaj e vënë në votim propozimin me plotësime dhe ndryshime , ku votohet për çdo propozim në vehte. Propozimi është aprovuar nëse për të kanë votuar shumica e anëtarëve prezent.

Kryesuesi konstaton se rendi i ditës është aprovua.

Neni 5.

- Raporti i KQZ mbi rezultatin e zgjedhjeve.

KKSH, konstituohet në mbledhjen e parë konstituive në bazë të raportit të **KQZ** në mbështetje të rezultateve të zgjedhjeve të mbajtura, ku pastaj ndahen mandatet dhe iu dorzohen vërtetima mbi zgjedhjen e tyre për anëtar të KKSH.

Neni 6.

-Verifikimi i mandateve të anëtarëve të KKSH.

Verifikimin e mandateve e bënë ose e udhëheqin përfaqësuesit e ministrisë për të drejtat e njeriut dhe pakicave, dhe ate me thirrje të kandidatit, duke e ftuar në emër ,mbiemër vendbanim si dhe listën nga cila vjenë.Kandidati të cilit i verifikohet mandati duhet që publikisht të deklarohet se a e pranon mandatin.

Neni 7.

Nëse në mbledhjen konstituive nuk janë prezent kandidatët nga lista zgjedhore nga e cila vjen, ose nëse kandidati refuzon ta pranojë mandatin , mandatet e të paradhiturve i ndahen kandidatëve ne mbledhjen e ardhëshme mvarësisht proporcionalisht nga numri i votave të fituara në zgjedhje.

Neni 8.

Anëtarit verifikimi i mandatit të cilit i shtyhet ka të drejt të marrë pjesë në mbledhje dhe të merr pjesë ne punën e tij pa të drejt vendosjeje ma së shumti **30**.ditë, pas këtij afati mandati i tij verifikohet ose mandati i jipet kandidatit tjetër sipas rradhitjes në listën zgjedhore nga e cila vjenë.

Neni 9.

- Dhënja e deklaratës solemne e anëtarëve të KKSH.

Me verifikimin e mandatëve kandidatëve të cilëve i është verifikuar mandati, japin deklaratën solemne me nënshkrimin e tekstit të deklaratës solemne që ka këtë përmbajtje:

„ Deklaroj se të drejtat dhe detyrat e anëtarit të KKSH. do ti kryej në pajtim të Kushtetutës, ligjit për Këshillat kombëtare të pakicave kombëtare , dhe akteve tjera ligjore po në interes të qytetarëve të pakicës kombëtare shqiptare,,

Neni 10.

- Zgjedhja e presidencës së punës ose komisionit zgjedhor.

Pas verifikimit të mandatit të anëtarëve të KKSH, gjer në zgjedhjen e kryetarit të KKSH, mbledhjen e udhëheq presidenca e punës, ose komisioni zgjedhor në përbërje prej tre anëtarëve të KKSH.

Neni 11.

Propozimin për presidencën e punës e japin më së paku **1/3** e anëtarëve prezent të KKSH.

Propozimi dorëzohet në formë të shkruar, dhe duhet të jetë qartë i cekur se kush do të jetë kryetar apo kryesues i mbledhjes, e kush do të jenë dy ndihmësit e tij , të cilët do ti ndihmojnë kryesuesit për udhëheqjen e mbledhjes, dhe poashtu propozimi duhet të jetë i nënshkruar nga anëtarët të KKSH.

Anëtari i KKSH, mundet të jap vetëm një propozim për presidencën e punës, ose komisionit zgjedhor.

Neni 12.

Propozimi për presidencën e punës apo komisionit zgjedhor, zgjidhet me shumicë votash të hapura nga anëtarët prezent të KKSH, ku pastaj anëtarët e komisionit zgjedhor, zgjedhin nga rradha e vetë kryesuesin ose kryetarin e presidencës sëpunës apo të komisionit zgjedhor.

Neni 13.

- Zgjedhja e kryetarit.

Kryetari i KKSH . zgjidhet nga radha e anëtarëve të KKSH. në mandat **4** vjeçar, sipas dispozitave të parapara me ligj dhe statut të KKSH.

Propozimin për kryetar të KKSH. mund ta dorëzojnë më së paku **1/3** e anëtarëve të KKSH.

Anëtari i KKSH, mund të merë pjesë në propozim vetëm të një kandidati për kryetar të KKSH.

Propozimi dorëzohet në formë të shkruar dhe duhet të jetë i nënshkruar nga ana e anëtarëve të cilët e propozojnë kandidatin për kryetar.

Neni 14.

Propozimi përmban emrin, mbiemrin e kandidatit biografin e shkurtër, nënshkrimet e anëtarëve të KKSH.

Anëtarët e KKSH, zgjedh kryetarin e KKSH, me vota të mshefta.

KKSH. mundet me shumicë votash të anëtarëve e vetë të vendos që kryetari i KKSH, të zgjidhet me vota të hapura.

Votimi i msheftë apo i mbyllur, bëhet me fletvotime, ku para emrit të kandidatit vëhet numri rendor.

Votimi bëhet me rethimin e numrit rendor para emrit të kandidatit për të cilin kandidati voton.

Për kryetar të KKSH, është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i tërësishëm i anëtarëve, (**me shumicë absolute**)

Nëse kryetari i KKSH, nuk zgjidhet përsëritet procedura e zgjedhjes, deri në zgjedhjen e kryetarit.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e kryetarit të KKSH. janë të përcaktuara në statut të KKSH. dhe ligj.

Kryetari për punën e vetë i përgjigjet KKSH.

Kryetarit të KKSH, i pushon mandati edhe para skadimit të afatit me dorëheqje me shkrim, apo me shkarkim, në mbështetje të dispozitave të ligjitë dhe të statutit.

Neni 15.

- Miratimi i rregullores së punës të Këshillit kombëtarë i pakicës kombëtare shqipëtarë.

KKSH, bien rregullore e punës në mbështetje të ligjit për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare , statutit dhe aktet tjera normative.

Me këtë rregullore rregullohet organizimi dhe mënyra e punës së këshillit kombëtare të pakicës kombëtare shqipëtare.

Neni 16.

Rregullore e punës e propozon kryetari i KKSH. kurse aprovohet me **shumicë votash nga anëtarët prezent të KKSH. në mbledhje**, nëse me dispozitat e statutit nuk është rregulluar ndryshe.

Rregullorja e punës mund të plotësohet, ndryshohet me propozim **e kryetarit të KKSH, dhe 1/3 e anëtarëve të KKSH.**

III. ZGJEDHJA E NËNKRYETARIT DHE SEKRETARIT TË KKSH.

Neni 17.

1. Zgjedhja e nënkryetarit.

KKSH, ka nënkryetarët e vet të cilët zgjidhen me procedurë të njejtë si zgjedhja e kryetarit të KKSH. Nënkryetarët e zëvendësojnë kryetarin e KKSH. në mungesë të tij apo me autorizim të posaçëm të kryetarit.

Nënkryetarët për punën e vetë i përgjigjen kryetarit dhe KKSH.

Kompetencat dhe përgjegjësit e nënkryetarëve janë të përcaktuara në statutin e KKSH.

Nënkryetarët shkarkohen në procedurë të njejtë si që janë zgjedhur, kurse mandati i tyre pushon në bazë të dispozitave të cekura në statut të KKSH.

Neni 18.

2. Zgjedhja e sekretarit të KKSH.

KKSH, ka sekretarin e vet i cili zgjidhet me vota të mbyllura, me shumicë votash të anëtarëve prezent, në propozim të kryetarit të KKSH, në formë të shkruar i arësytuar dhe në kushtet si është përcaktuar me ligj.

KKSH. mund që me shumicë votash të anëtarëve të KKSH të vendosë që sekretari të zgjidhet me vota të hapura.

Për sekretarë të KKSH mund të zgjidhet kandidati i cili ka përgaditjen profesionale të lartë apo superiore të fakultetit juridik ose ekonomik.

Sekretari i KKSH, zgjidhet në mandat **4**. vjeçar ose në kohëzgjatje të mandatit të KKSH. dhe kryen punët që janë të caktuara me ligj dhe me statut.

Sekretarit të KKSH. mund ti pushon funksioni edhe para skadimit të mandatit, me dorëheqje me shkrim apo në propozim të kryetarit të KKSH.

IV. KOMISIONET E KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPËTARË.

Neni 19.

KKSH, për realizimin e të drejtave në vetëqeverisje në fushat apo lami të për kultur, arsim, informim dhe përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip formonë komisione, e të cilat janë:

Komisioni për arësim: parashkollor, fillor dhe të mesëm,

Komisioni për arësim të lartë dhe shkencë,

Komisioni për informim dhe botime,

Komisioni për kulturë,

Komisioni për përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip,

Komisioni për rini dhe shoqëri civile.

Neni 20.

Numri i anëtarëve nuk mund të jetë më pak se **5**. dhe më shume se **15**. anëtar.

Vendimi për formimin e këtyre komisioneve miratohet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të KKSH.

Neni 21.

Kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e komisioneve i emëron KKSH. në propozim të **kryetarit të KKSH** dhe **1/3 e anëtarëve të KKSH**. me shumicë votash të mëshefta-mbyllura, nga numri i përgjithshëm të anëtarëve të KKSH. në afat të mandatit të KKSH.

KKSH mund të vendos me shumicë votash të anëtarëve të KKSH që komisionet të zgjidhen edhe me vota të hapura.

Kryetari dhe anëtarët e komisioneve nuk do të thotë të jenë nga rradha e anëtarëve të KKSH.

Kryetari i KKSH dhe anëtarët e Organit Egzekutiv të KKSH nuk mund të jenë anëtarë të komisioneve.

Anëtari i KKSH. mund të jetë anëtarë vetëm i një komisioni.

Komisionet kanë kryetarin dhe nënkryetarin e tij, i cili e zavendëson në mungesë të tij apo me autorizim të posaqëm.

Për udhëheqjen e punëve administrative që kanë të bëjnë me komisione kujdeset sekretari i KKSH.

KKSH, mund të formonë edhe komisione tjera sipas nevojës.

Komisionet e KKSH i përgjigjen KKSH. një herë në vitë po edhe sipas nevojës.

Përbërja puna dhe kompetencat e komisioneve rregullohen me rregullore të posaqme duke u bazuar në ligj, dhe statut.

Neni 22.

KKSH. mund të formojë sipas nevojës edhe **trupa konsultativ dhe grupe punuese tjera**, nga lamitë të cilat bienë në kompetencën e saj e që janë:

Trupat konsultativ të KKSH. për bashkëpunimi me shtetin amë, me organet përfaqësuese gjegjësisht këshillat kombëtare të nacionaliteteve tjara në kuadër të shtetit, bashkpunimi me shtetet ku gjuha shqipe dhe shkrimi shqip është në përdorim zyrtar, si dhe bashkëpunimi me shtetet tjera sipas nevojës që paraqitet.

Trupat konsultativ dhe grupet punuese i përgjigjen KKSH.

Neni 23.

Mënyra puna dhe kompetencat e **trupave konsultativ dhe grupeve punuese**, rregullohet me rregullore të posaqme në mbështetje ligjit, statutit.

Neni 24.

Kryetarët, anëtarët e trupave konsultativ dhe grupeve punuese i zgjedh KKSH. me shumicë votash të anëtarëve prezent në propozim të kryetarit të KKSH apo **1/3** e anëtarëve, numri i anëtarëve mund të jetë prej **5-7**, të cilët nuk do të thotë të jenë nga rradha e anëtarëve të KKSH.

Neni 25.

KKSH zgjedh **organin mbykëqyrës**, si organ kontrollimi për punën që kryen KKSH, bazuar në statut dhe ligj.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi janë të regulluara me ligj dhe statut.

Neni 26.

KKSH, formon **shërbimin administrativ apo profesional** për kryerjen e punëve të KKSH, për përgaditjen e akteve dhe materijaleve tjera për mbledhje, e të cilët zgjidhen me shumicë votash të anëtarëve prezent, në propozim të kryetarit ose $1/3$ e anëtarëve të KKSH.

Shërbimin e udhëheq sekretari i KKSH.

V. MIRATIMI I AKTEVE JURIDIKE.

Neni 27.

1. Llojet e akteve

KKSH. mund të bien aktvendime, konkluzione, pëlqim, mendim propozime etj. në mbështetje të statutit dhe ligjit.

Me **aktvendime** emëron, formon, përcakton dhe vërteton.

Me **konkluzion** precizohen qëndrimet mendimet konstatimet obligimet autorizimet me rastin e shqyrtimeve të çështjeve të caktuara.

Me **pëlqim dhe mendim** jipen të gjitha pëlqimet që janë të caktuara dhe të precizuara në ligjin mbi pakicat nacionale.

Neni 28.

2. Procedura e miratimeve të akteve.

Propozimin e aktvendimeve dhe akteve tjera për miratim në mbledhje të KKSH e paraqet kryetari i KKSH. përveç propozimit të vendimit mbi planin financiar të KKSH, që e paraqet Organi Egzekutiv i KKSH.

Projektvendimet dhe aktet tjera të komisioneve, dhe grupeve tjera punuese për miratim i përgaditë sekretari i KKSH. në bashkpunim me shërbimin administrativ të KKSH.

Propozimi paraqitet në atë formë që duhet të jetë edhe i arsyetuar, arsyetimi përmban bazën dhe arsyet për miratim.

Neni 29.

Disa propozime para se të shqyrtohen në mbledhje të KKSH. duhen paraprakisht të shqyrtohen nëpër komisione apo edhe në grupe punuese përkatëse të lëmive të cilës i përket propozimi, e pastaj të dërgohet në mbledhje për miratim në KKSH.

Në mbledhje të KKSH. propozimet që janë vënë në rend dite vendoset pas diskutimit, përveç në rastet e veçanta kur me këtë rregullore është caktuar që të vendoset ndryshe, dhe atë pa diskutim.

Pas kryerjes së diskutimit kalohet në votim të propozimit.

Mbi propozimin votohet në tërësi, por nëse është paraqit amendament sëpari votohet për amendamentin e pastaj votohet mbi propozimin në tërësi.

Neni 30.

Propozuesi i akteve ka të drejtë dhe mund që në fillim të diskutimit të paraqet arsyetimin plotësues të propozimit, ai ka të drejtë të marrë pjesë në diskutim deri në përfundim të diskutimit mbi propozimin, që të jap sqarime dhe të paraqet mendimin e vetë.

Neni 31.

Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e propozimit dhe akteve tjera paraqitet me anë të amendamenteve.

Neni 32.

Amendamenti paraqitet me shkrim me arsyetim më së voni **2** ditë para mbajtjes së mbledhjes, me përjashtim kur mbledhja është paraqit urgjentisht amandamentet mund të paraqitën në vetë mbledhje.

Propozuesi i vendimeve apo akteve tjera mund të paraqesë amandament gjerë në fund të diskutimit, të propozimit.

Neni 33.

Paraqitja e amandamentit bëhet pjesë përbërëse e propozimit.

Nëse janë paraqit amandamente më shumë, për të njeitin nen të propozimit më parë vendoset për amandamentin që ka të bëjë për shlyerjen e atij neni.

Aktet që i miraton KKSH. ndërsa për miratimin e të cilës është paraparë me ligj pëlqimi nga ana e ministrisë kompetente ose ndonji institucioni përgjegjës, mund të miratohet në mbledhje pas marjes së pëlqimit gjegjësisht mendimit.

Neni 34.

Në rastet urgjende propozimi mund të paraqitet gjatë mbajtjes së mbledhjes, dhe poashtu të vendoset në mbledhje për çështjet për të cilat janë urgjente kështu që nëse do të miratohej një çështje e tillë në procedurë të rregullt do të sjellte pasoja të rënda.

Neni 35.

3. Ruajtja dhe shpallja e akteve.

Në vendimet origjinale dhe aktet tjera që i bie apo miratohen në mbledhje vihet vula e KKSH, të cilët ruhen në arkivin e KKSH, dhe për të cilën kujdeset sekretari i KKSH.

Aktet të cilat i miraton KKSH. shpallen në gazetën zyrtare të Sërbisë, dhe është detyrë e sekretarit të KKSH.

VI. MBLEDHJET E RREGULLTA DHE TË JASHTËZAKONSHME TË KKSH.

Neni 36.

1.Mbledhjet e rregullta.

Mbledhjet e KKSH. mbahen sipas nevojës e më së paku **4** herë në vit.

Mbledhjen e KKSH. e konvokon kryetari i KKSH sipas iniciativës së vet,**1/3** e anëtarëve të KKSH dhe **1/3** e anëtarëve të Organit Egzekutiv,

Neni 37.

Kryetari është i obliguar që në afat prej **5** ditësh të konvokoj mbledhjen , kur atë me shkrim e kërkon propozuesi nga neni i mëparshëm.

Ftesat për mbledhje i dërgohen anëtarëve më së voni **3** ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes.

Anëtarëve të KKSH. i dorëzohet me ftësë propozimi i rendit të ditës, materilali përkatës, për çëshjet që propozohen për rendë dite si dhe procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Neni 38.

Në mbledhje përveç anëtarëve të KKSH.mund të ftohen edhe anëtarët e Organit Egzekutiv sipas nevojës, si dhe përfaqësues të tjerë nëse parashifet nevoja.

Neni 39.

2. Mbledhjet e jashtëzakonshme.

Në rastet urgjente kryetari i KKSH, mund të caktojë mbledhjen në afat edhe më të shkurtër se **3** ditë, ndërsa rendin e ditës mund të propozon në vetë mbledhje.

Kur mbledhja mbahet sikur u cek në alinenë e mëparëshme të këtij neni amandamentet mund të paraqiten në vetë mbledhje dhe ate me shkrim apo me gojë.

VII. PROCEDURA E HAPJES SË MBLEDHJES DHE RENDI I DITËS.

Neni 40.

1. Hapja e mbledhjes

Kryetari hap mbledhjen e rradhës kur në bazë të evidencës zyrtare vërtetohet se janë prezent shumica e anëtarëve të KKSH. mirëpo nëse ndonjë anëtar shpreh dyshimin në egzistimin e kворumit për punë bëhet thirja e anëtareve sipas listës.

Neni 41.

2. Rendi i ditës.

Propozimin për rendin e ditës e propozon **kryetari i KKSH, 1/3 e anëtarëve të KKSH .si dhe anëtarët e Organi Egzekutiv**, kurse rendin e ditës e cakton kryetari i KKSH.

Në procedur të caktimit të rendit të ditës veçmas vendoset mbi çdo propozim konkret.

Pyetjet e anëtarëve dhe inicijativat janë pikat e fundit të rendit të ditës.

Në rend dite hyjnë edhe përgjigjet në pyetjet e anëtarëve.

Rendi i ditës aprovohet në tërësi me ndryshime dhe plotësime.

Rendi i ditës aprovohet në fillim të mbledhjes me shumicë votash të anëtarëve prezent.

Neni 42.

3. Puna në mbledhje.

Puna e mbledhjes është publike, mirëpo mund të jetë edhe e mbyllur për opinion, ku propozimin e arësytuar e jep kryetari dhe votohet pa diskutim.

Para se të fillohet në rend dite miratohet proqesverbali nga mbledhja e kaluar, për vërejtjet në proqesverbal në mbledhje votohet pa diskutim.

Diskutimi në lidhje me pikat e rendit të ditës bëhet sipas rradhitjes së caktuar.

Mbi shqyrtimin e pikave të caktuara pa rradhitje vendos kryetari i KKSH.

Para diskutimit të çdo pike përfaqësuesi i propozimit mund të jap fjalën hyrëse, pas paraqitjes së fjalës hyrëse kryesuesi hap diskutim mbi çështjen konkrete.

Askush nuk mund të flas në mbledhje para se ta kërkojë dhe ta marrë fjalën nga kryetari.

Kryetari ia jep fjalën anëtarëve sipas rradhës së lajmërimit gjerë sa ka folës, Folësi i cili dëshirron ta marr për herë të dytë fjalën ka të drejtë pasi të kryhet lista e folësve që flasin për herë të parë.

Neni 43.

Sekretarit të KKSH. i jipet fjala sipas nevojës së paraqitur, kurse krytarëve të komisioneve dhe Kryetarit të Organit Egzekutiv i jipet fjala kur janë të ftuar në mbledhje sa herë kërkohet nevoja.

Askush nuk mund të ndërpres folësin e as të ia tërheqë vërejtjen përveç kryetarit KKSH.

Folësi mund të flasë vetëm mbi çështjen që është në rend dite jo më gjatë se **10** min.

Anëtari ka të drejtë që të jap sqarime nëse në diskutimin e më parshëm ceket në mënyrë direkte ose indirekte personaliteti i tij, ose fjalët e tij janë interpretuar gabimisht. Në këtë rast kryetari ia jep fjalën, gjë që nuk mund të flasë më tepër se **2**.min.

Mbledhja e KKSH. zgjatë prej ora _____ deri më _____

Kryetari e ndërpret mbledhjen kur e vërteton se nuk ka kforum, përshkak të nevojës që të kryhen pregaditjet e duhura dhe të mirren mendimet, si dhe në rastet tjera, ku caktohet termini i vazhdimit të saj.

Pushimi vjetor i punës mbledhjes së KKSH. është _____

Neni 44.

4. Shkelja e rregullores së punës të KKSH.

Çdo akt dhe punë apo veprim tjetër që paraqet heqje dorë nga procedura në punën e mbledhjes paraqet shkeljen e rregullores së punës.

Anëtari KKSH. i cili dëshiron të marë fjalën ose të flasë mbi shkeljen e rregullores së punës së KKSH, Kryetari i KKSH ia jep fjalën kur e kërkon, gjegjësisht menjëherë pas kryerjes së diskutimit të folësit të mëparshëm.

Anëtari duhet të cekë dispozitën e rregullores që mendon së është shkelur.

Neni 45.

Kryetari ndërpre diskutimin e çështjes lëndore dhe jep sqarime mbi shkeljen e rregullores. Nëse anëtari nuk është i kënaqur me sqarimin e kryetarit atëherë vendoset me votim në mbledhjen e KKSH. pa diskutim.

Në mbledhje vendoset mbi shkeljen e rregullores me shumicë votash të anëtarëve prezent.

Neni 46.

5. E drejta në replikë.

Anëtari i KKSH. ka të drejt të replikojë nëse në diskutimin e më parshëm në mënyrë fyese është folur për të ose fjalët e tij janë keqëinterpretuar.

Anëtarëve të përmendur nga alinea 1 e këtij neni kryetari ua jep fjalën menjëherë.

Anëtari mund të flasë me së shumti **1** minutë.

Neni 47.

6. Vendosja në mbledhje të KKSH.

Në mbledhje vendoset me shumicë votash të anëtarëve prezent, me përjashtim kur me ligj apo statut kërkohet shumica absolute për miratim.

Gjatë votimit kryetari fton anëtarët që të deklarojnë kush është – **për**- e kush është-**kundër**- e kush është për **apstenim**.

Pas kryerjes së votimit kryetari vërteton rezultatin e votimit në bazë të cilit shpallet së propozimi për të cilën është diskutuar a është miratuar apo jo.

Neni 48.

Nëse më shumë se **1/3** e anëtarëve të KKSH. shprehin dyshimin në rezultatin e paraqitur të votimit fillohet me numrimin e votave dhe ajo mund të bëhet vetëm njëherë për çështjen e njejtë.

Neni 49.

7. Mbajtja e rendit në mbledhje.

Mbi rendin në mbledhje kujdeset kryetari.

Për shkeljen e rendit në mbledhje, kryetari mund të shqipton masën e tërheqjes së vërejtjes ose marrjes së fjalës.

KKSH. në propozim të kryetarit mund të shqipton masën e largimit nga mbledhje.

Neni 50.

Masa e tërheqjes së vërejtjes i shqiptohet anëtarit i cili me sjelljet e veta, prish rendin në mbledhje ose vepron në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore.

Neni 51.

Masa e marrjes së fjalës shqipëtohet anëtarit, kur anëtari i cili në fjalimin e vetë prish rendin në mbledhje ose nuk i përmbahet çështjes që është në rend dite, ndërsa dy herë i është tërheq vërejtja që ti përmbahet rendit dhe dispozitave të rregullores.

Neni 52.

Masa e largimit nga mbledhja shqiptohet anëtarit atëherë kur edhe pas shqiptimit të masës për tërheqjen e vërejtjes gjegjësisht masës së marrjes së fjalës pengon punën e mbledhjes fyen KKSH, organet e saj dhe anëtarët, ose përdor shprehje që nuk janë në pajtim me dinjitetin e KKSH.

Anëtari mund të largohet vetëm nga ajo mbledhje që e ka prishur rendin e mbajtjes së mbledhjes. Masa e largimit shqiptohet pa diskutim.

Anëtarit të KKSJ. ndaj të cilit shqiptohet masa e largimit nga mbledhja është i obliguar që menjëher të dal apo të lëshoj mbledhjen.

Nëse kryetari me masat e shqiptuara nuk mund të mbaj rend në mbledhje do të cakton ndërprerjen e shkurtër të mbledhjes.

Dispozitat për mbajtjen e rendit në mbledhje zbatohen edhe ndaj të gjithë personave tjerë që marin pjes, apo janë të pranishëm në mbledhje.

Neni 53.

8.Proçesverbali nga mbledhjet e mbajtura.

Mbi punën dhe ecurin e mbledhjes udhëhiqet proçesverbal.

Në proçesverbal veohen këto shënime:

- Koha dhe mbajtja e mbledhjes,
- numri i anëtarëve të pranishëm,
- emrat e anëtarëve që mungojnë,
- emrat e të pranishmëve të tjerë që nuk e kanë cilesinë e anëtarit të KKSJ,
- vërtetimi i rendit të ditës.
- emrat e pjesëmarrësve në diskutim,
- shënime mbi rezultatin e votimeve.

Dispozita përfundimtare e proçesverbalit është shënim mbi kohën e përfundimit të mbledhjes.

Proqesverbalin e nënshkruan kryetari i KKSH si dhe sekretari i KKSH.

Mbi ruajtjen e proqesverbalit original kujdeset sekretari i KKSH.

VIII. PUNA E MBLEDHJES ,NË RAST TË RREZIKUT TË DREJTËPËRDREJT TË LUFTËS,GJENDJES SË LUFTËS,LUFTËS DHE ASAJ TË JASHTZAKONSHME.

Neni 54.

KKSH. vazhdon punën me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, rrezikut të drejtëpërdrejt të luftës ose gjendjes së luftës deri në ditën e zgjedhjes së përbërjes së re.

Neni 55.

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen në punën e KKSH. edhe në rastet e cekura nga neni i mëparshëm, nëse me akte tjera juridiku nuk është rregulluar ndryshe, këtë mbledhje e konvokon kryetari në mënyrën dhe afatet e përshtatshme të rrethanave për konvokim e mbledhjes . Në këtë rast nëse mungojnë numri i mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes , mbledhja mbahet me numrin e atyre që janë prezent.

Neni 56.

Nëse mbledhja nuk mund të organizohet, punët dhe detyrat nga kompetenca e KKSH , i kryen kryetari i KKSH, gjë që është i obliguar që në mbledhjen e parë të KKSH. të paraqet raport mbi punën e ndërmarë gjatë asaj kohe apo periudhe, për arsye të verifikimit të punës së kryer.

Anëtarët e KKSH. janë të obliguar që në rast të gjendjes së cekur në nenin e mëparshëm ta njohtojnë sekretarin e KKSH. për çdo ndryshim të adresës së vendbanimit ose të vendqëndrimit.

IX. PUNA PUBLIKE E MBLEDHJES.

Neni 57.

Puna e kuvendit është publike.

Neni 58.

Në mbledhjet e KKSH. komisioneve dhe grupeve tjera punuese të KKSH. mund të marrin pjesë përfaqësuesit e shtypit dhe informimit publik, ku para hyrjes në mbledhje gazetarët e akredituar janë të obliguar që të tregojnë lejën e tyre të punës si gazetarë të mjeteve të informimit nga vijën, si dhe qëndrimi i tyre duhet të jetë në vendin e caktuar.

Neni 59.

Gazetarëve të akredituar i vihen në dispozicion propozimet e vendimeve dhe akteve tjera të përgjithme për çështjet e punës së kuvendit.

Në mbledhje mund të prezantojnë edhe qytetarët,

Qytetari i cili don të marrë pjesë në mbledhje duhet të lajmërohet te sekretari i KKSH. ta dorëzojë letërnjohtimin për hirë të identifikimit.

Në lidhje me punën e KKSH. mund të japë informim zyrtar për shtyp dhe për mjetet tjera të informimit, Kryetari i KKSH. si dhe personi tjetër sipas autorizimit të kryetarit të KKSH.

Konferencën për shtyp në lidhje me ecurin e mbledhjes mund ta jap kryetari ose personin të cilin e autorizon kryetari i KKSH.

X. ORGANI EGZEKUTIV I KKSH.

Neni 60.

Organi ekzekutiv ka **kryetarin** dhe **nënkryetarin** si dhe **7** anëtar.

Kryetari i, nënkryetari dhe anëtarët e O.Egzekutiv zgjidhen me vota të mëshefta apo të mbyllura.

KKSH. mund të vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të KKSH. që kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e OE . të zgjidhen me vota të hapura.

Neni 61.

Propozimin për kryetar, nënkryetar dhe anëtarë të OE, mund ta bëjë kryetari i KKSH. ose **1/3** e anëtarëve të KKSH, propozimi ipet në formë të shkruar me arësytim të qartë se kush është kandidat për kryetar ,nënkryetar ose anëtar të Organit Egzekutiv.

Procedura e shkarkimit e kryetarit nënkryetarit dhe anëtarëve të Organit Egzekutiv është e njejtë si procedura e zgjedhjes.

Puna përgjegjësitë dhe kompetenca e Organit Egzekutiv rregullohet me rregullore të posaqme.

Neni 62.

Kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e OE. nuk don të thotë të jenë anëtarë të KKSH.

Organi egzekutiv jep raport sëpaku njeherë në vitë KKSH. mbi punën e tij, mirëpo edhe saherë e kërkon nevoja.

Kompetenca dhe përgjegjësitë e Organit Egzekutiv janë përcaktuara në statutin e KKSH,ligj dhe rregulloren e saj.

Organi egzekutiv i dorëzon KKSH programin dhe raportin e punës, planin financiar dhe raportin financiar për miratim më së paku një herë në vitë.

Mandati i O.Egzekutiv zgjatë po aq sa zgjatë mandati i KKSH.

XI. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE TË KKSH.

Neni 63.

Anëtari i KKSH. ka të drejt dhe obligim të marrë pjesë në mbledhje të KKSH. të komisioneve dhe grupeve tjera punuese , aty ku janë anëtar që të merë pjesë në punën e tyre dhe të kërkon informatë që u janë të nevojshme për të vendosur për çështjen që diskutohet,apo që është në rend ditë, nga shërbimi administrativ i KKSH. apo sekretarit të KKSH.

Neni 64.

Anëtari i KKSH. ka të drejtë që të prezentoj në mbledhjen e komisioneve e tjera edhe ku nuk është anëtar, dhe të merë pjesë në punën e tyre pa të drejtë vendosjeje.

Anëtari i cili për shkaqe të arësyeshme nuk mund të prezentojë në mbledhje e njohton për atë kryetarin apo sekretarin e KKSH,

Neni 65.

Anëtari ka të drejtë në kompenzim të shpenzimeve të rrugës dhe mëditjes së humbur duke kryer obligimet e anëtarit të KKSH. të cilën lartësi e cakton me vendim të posaqëm Organi Egzekutiv apo kryetari i KKSH.

XII. PYETJET E ANËTARËVE TË KKSH.

Neni 66.

Anëtari i KKSH, ka të drejtë të shtrojë pyetjen e anëtarit.

Pyetjet e anëtarit mbështeten në punët dhe detyrat nga kompetenca e vet. Pyetja e anëtarit dorëzohet me shkrim, kurse në mbledhje mund të jipet edhe me gojë gjë që është i obliguar që në afat prej **3** ditësh ta bëjë me shkrim nga mbledhja e mbajtur përdryshe pyetja e tillë nuk mund të muret parasysh në procedur të mëtejme.

Kryetari mundet të ia tërheq vërejtjen anëtarit që pyetjen të cilën e shtron nuk është konformë rregullores.

Neni 67.

Përgjigjet në pyetje dorëzohen me shkrim në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje në mbledhjen e parë, pas parashtrimit të pyetjes, mirëpo në rast se për përgjigjen në pyetjen e anëtarit kërkohen analiza të hollësishme -profesionale atëherë përgjigja në pyetje do të jetë në afat më të gjatë por jo më shumë se **30** ditë.

Pas përgjigjes së dhënë në pyetjen e anëtarit, anëtari që e ka parashtruar pyetjen ka të drejtë që në zgjatje prej **2** minutash të propozoj hapjen e diskutimit në njërin nga mbledhjet e ardhëshme të KKSH. lidhur me përgjigjen.

XII. DISPOZITAT KALUESE DHE PËRFUNDIMTARE.

Neni 68.

Gjithëçka që nuk është rregulluar me këtë rregullore në mënyrë direkte aplikohen dispozitat e ligjit , statutit. si dhe dispozitat tjera që rregullojnë këtë lami.

Neni 69.

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit kurse shpallet në gazetën zyrtare të R.Sërbisë.

KËSHILLI KOMBËTARË I PAKICËS KOMBËTARE SHQIPTARE

Krtyetari Këshillit Kombëtar Shqiptar

V.V.

Galip Beqiri
